VENDIM
Nr.230, datë 15.4.2005

PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QENDRËS KOMBËTARE TË CILËSISË, SIGURISË DHE AKREDITIMIT TË INSTITUCIONEVE SHËNDETËSORE DHE PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.306, DATË 27.6.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE ME ARSIM TË LARTË NË SISTEMIN E MINISTRISË SË SHËNDETËSISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e qendrës kombëtare të cilësisë, sigurisë dhe akreditimit të institucioneve shëndetësore, si institucion buxhetor, në varësi të Ministrit të Shëndetësisë, për përmirësimin e cilësisë e të shërbimeve shëndetësore, nëpërmjet hartimit të metodave të matjes e zbatimit të standardeve e të treguesve të matshëm për sistemin shëndetësor dhe për promovimin e praktikave më të mira shëndetësore.

2. Emërimi dhe lirimi nga detyra i drejtorit të qendrës kombëtare të cilësisë, sigurisë dhe akredimit të institucioneve shëndetësore bëhet në përputhje me procedurat e përcaktuara në vendimin nr.173, datë 7.3.2003 "Për emërimin, lirimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të ministrit".

3. Efektet financiare, që lindin nga zbatimi i këtij vendimi dhe organika e kësaj qendre të përballohen, përkatësisht, nga buxheti dhe numri i përgjithshëm i punonjësve, miratuar për vitin 2005 për Ministrinë e Shëndetësisë.

4. Lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet vendimit nr.306, datë 27.6.2002, t'i shtohet "Lidhja I, (kreu I.10)", që i bashkëlidhet këtij vendimi, për përcaktimin e pagave të punonjësve të qendrës kombëtare të cilësisë, sigurisë dhe akreditimit të institucioneve shëndetësore.

5. Ngarkohen Ministri i Financave dhe Ministri i Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

LIDHJA 1
(KREU 1.10)

STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT ME ARSIM TË LARTË NË QENDRËN KOMBËTARE TË CILËSISË, SIGURISË DHE AKREDIMIT TË INSTITUCIONEVE SHËNDETËSORE

Emërtimi	Paga mujore					
	Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
	1	2	3	4	5	
Drejtor	9306	2%	0	76 516		Nga..deri...lekë
Shef sektori	9306	2%	0	50 666		Nga..deri...lekë
Specialist	9306	2%	0	40 326		Nga..deri...lekë